



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 654/4 prot.

Vlorë, më 21 . 05 .2018

VENDIM

Nr. 23, datë 08.05.2018

**PËR
RREGULLOREN E QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE TË FAKULTETIT TË
SHKENCAVE TEKNIKE, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Mbështetur në nenin 33, pika 3, nenin 38, pika 1, shkronja d të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.05.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike, Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë.
2. Teksti i rregullore ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike, Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike, personeli i qendrës.
4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE

**E QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE
TEKNIKE, UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”, VLORE**

Grupi i punës

Dr. Sonila Kane

Dr.Pëllumb Cacaj

Dr.Bledar Pepa

Dr.Alketa Hyso

Msc. Suard Alizoti

janar 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

PËRMBAJTJA

		Faqe
KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	4
Neni 1	Baza ligjore e Rregullores	4
Neni 2	Statusi juridik	4
Neni 3	Përkufizime	4
KREU II	OBJEKTI I VEPRIMTARISË	5
Neni 4	Qëllimi i rregullores së QKSH	5
Neni 5	Misioni i QKSH	5
Neni 6	Detyrat kryesore të QKSH	6
Neni 7	Fushat e studimit	7
Neni 8	Aktivitetet e QKSH-së	8
Neni 9	Kualifikimi i stafit	8
Neni 10	Infrastruktura Kërkimore-Shkencore	8
KREU III	STRUKTURA ORGANIZATIVE E QKSH-FSHT	9
Neni 11	Përbërja dhe struktura e QKSH-FSHT	9
Neni 12	Funksionet e stafit të QKSH	9
Neni 13	Mbledhjet e stafit të QKSH	10
KREU IV	DREJTIMI I QENDRËS KËRKIMORE-SHKENCORE	10
Neni 14	Drejtuesi i qendrës	10
Neni 15	Tagrat e përfaqësimit	10
Neni 16	Kompetencat	10
Neni 17	Rregullat e punësimit	11
Neni 18	Etika në punë	11
KREU V	BURIMET E FINANCIMIT	12
Neni 19	Viti financiar	12
Neni 20	Burimet bazë të financimit	12
KREU VI	ETIKA NË VERPIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE	12
Neni 21	Veprimtaria kërkimore-shkencore	12
Neni 22	Monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë kërkimore	13
Neni 23	Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore	13
Neni 24	Autorësia	14
Neni 225	Garantimi i etikës dhe konfidencialitetit	14
KREU VII	DISPOZITA TË VECANTA	15
Neni 26	Vlerësimi i cilësisë	15
Neni 27	Analiza vjetore e veprimtarisë së QKSH	15
Neni 28	Vlefshmëria e rregullores	15



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore e Rregullores

Baza ligjore në të cilën mbështetet Rregullorja e Qendrës Kërkimore Shkencore është Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 26 "Qendrat Kërkimore-Shkencore", Statuti dhe Rregullorja e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 2
Statusi juridik

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.80/ 2015 të Arsimit të Lartë, bazuar në Vendimin Nr. 10, Dt. 27.01.2017 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë "Për miratimin e strukturës organizative dhe organigramës së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë" në çdo fakultet të Universitetit u hapën Qendrat Kërkimore Shkencore.

Qendra Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Shkencave Teknike është vazhdimësi e Qendrës së Kërkimit Shkencor "Qendra për Studimet e Mjedisit" e cila është hapur për herë të parë me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Vlorës Nr. 14.1, dt. 24.11.2008.

Emërtimi i shkurtuar i Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike është: "QKSH-FSHT".

Selia e saj ndodhet në Vlorë në adresën: Fakulteti i Shkencave Teknike, Godina C, Sheshi Pavarësia, Skelë-Vlorë.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"QKSH-FSHT" nënkupton Qendrën Kërkimore Shkencore të Fakultetit të shkencave Teknike.

"Strukturë Organizative" nënkupton stafin akademik dhe ndihmësakademik të QKSH-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU II
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4
Qëllimi i rregullores së QKSH

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj dhe në mbështetje të veprimtarisë kërkimore-shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike të Universitetit 'Ismael Qemali' Vlorë dhe e shtrin veprimin e saj në Qendrën Kërkimore Shkencore, personelin akademik, personelin ndihmës akademik, studentët e Fakultetit dhe bashkëpunëtorët e institucionit.

Rregullorja e Qendrës Kërkimore Shkencore përcakton misionin e veprimtarisë së QKSH, vendos rregullat normative të organizimit të studimeve dhe projekteve në fushën Kërkimore-Shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve, rregullat për pranimin e projekteve, për kërkimin, për vlerësimin, për publikime, për rekrutimin e personelit dhe parashikon masat në rastin e shkeljes së rregullores.

Neni 5
Misioni i QKSH

Qendra Kërkimore Shkencore e FSHT ka si mision:

- Krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësimin e realizimit të kërkimit shkencor nga ana e stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Teknike pranë ambienteve të saj.
- Të mbështesë realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" dhe "Doktoratë", të ofruara nga departamentet e fakultetit.
- Të bëhet pjesë e financimeve nga granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese ku përfshihen fondet për kërkimin shkencor, të monitorojë dhe të administrojë studimet dhe projektet në fushën e Shkencës, Kërkimit, Mjedisit etj.
- Të funksionojë si një strukturë koordinuese për studime dhe projekte brenda Fakultetit, grupeve kërkimore shkencore të njëjësive bazë dhe bashkëpunime me Institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit bazuar në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave Teknike dhe këtyre institucioneve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Të rrisë rendimentin e aplikimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim edhe me departamentet e FSHT dhe me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve.
- Vënie në shërbim të rajonit dhe më gjerë të rezultateve të kërkimit shkencor nëpërmjet realizimit të projekteve kërkimore të përbashkëta me njesitë vendore, universitete brenda dhe jashtë vendit. QKSH do të vazhdojë të konsolidojë marrëdhëniet e krijuara me partnerët e vet, si në planin kombëtar edhe atë ndërkombëtar, duke vijuar kontaktet në të gjitha drejtimet.
- Të menaxhojë projekte dhe studime në fusha të ndryshme kërkimore si dhe transferimin, modernizimin dhe inovacionin e teknologjive të reja.
- Qendra, nëpërmjet anëtarëve të saj, siguron mbështetje për studimin, koordinimin, implementimin dhe përhapjen e kërkimit shkencor nga kërkuesit shkencor të FSHT. Gjithashtu, Qendra mbështet trajnimin e gjenerateve të reja të kërkuesve në fushat e studimit që ajo ofron.
- Të jetë në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve.
- Ofrimin e shërbimeve (kryerja e analizave) për palë të interesuara.
- Organizimi në mënyrë periodike (çdo dy-tre vjet) dhe pjesëmarrja në Evente të ndryshme shkencore si Konferenca Shkencore, WorkShop, Seminare në të cilat Qendra Kërkimore Shkencore do të bëjë publike rezultatet e kërkimit shkencor të realizuar nga stafi akademik apo edhe studentë.
- Botimi i një Reviste Shkencore në mënyrë periodike nga ana e QKSH të FSHT ku do të mund të pasqyrohen arritjet e kërkimit shkencor të stafit akademik apo studentëve të FSHT, por jo vetëm.
- Bashkëpunimi dhe financimi nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) për projekte kërkimore dhe projekte zhvillimi.
- Qendra do të funksionojë në dispozicion të personave që kryejnë studime post-doktorale.

Neni 6

Detyrat kryesore të QKSH

Detyrat kryesore të QKSH-së janë:

- Kryerja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe zhvillimit në fushën e mjedisit, shkencave natyrore, kompjuterike, teknike e detare.
- Pranë Qendrës Kërkimore Shkencore, çdo anëtar i stafit akademik të FSHT-së dhe student i ciklit të studimeve "Master i Shkencave" (në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës) dhe "Doktoratë" mund të realizojë kërkim shkencor pasi të ketë paraqitur:
 - *Kërkesë të miratuar nga Përgjegjësi i Departamenti dhe Dekani.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- *Planin e punës që do të realizohet ku të pasqyrohen nevojat, imput-et dhe output-et.*
 - *Në përfundim, rezultatet e arritura do të depozitohen pranë Qendrës së Kërkimit Shkencore edhe Biblotekës.*
-
- Bashkëpunimi me njësitë e tjera bazë të Fakultetit, institucionet e tjera kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe promovon kërkimin në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit;
 - Koordinimi dhe realizimi i projekteve, programeve dhe studimeve të qendrës në përputhje me përparësitë e përcaktuara nga Fakulteti.
 - Krijimi dhe pasurimi në mënyrë të vazhdueshme i një database mbi të dhënat e analizave dhe dokumentacionit të sistemit të Qendrës Kërkimore Shkencore;
 - Krijimi, në bashkëpunim me departamentet i një data base me temat e diplomave të ciklit të dytë dhe III dhe kerkimin shkencor të stafit akademik të njësisive bazë.
 - Siguron bashkëpunim me të tretët në fushën kërkimore-shkencore në sajë të marrëveshjeve edhe me departamentet në përputhje me politikat financiare të miratuara në organet përkatëse.
 - Ofron ekspertizë, bashkërendon dhe monitoron bashkëpunimin dy dhe shumëplanësh me agjensi dhe organizma kerkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit ne kuadër të direktivave të BE-së.
 - Zbaton politikat e qeverisë për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe të shkencëtarëve të rinj në veprimtarinë e QKSH;
 - Ofron mbështetje teknike për njësitë e tjera bazë të Fakultetit, për përmirësimin e plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor, në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.
 - Angazhimipër antarësimin në rrjete Evropiane dhe Ndërkombëtare.
 - Organizon shkolla verore (summer school) si vetëm ashtu dhe në bashkëpunim me institucione e qendra të tjera vendase apo të huaja.
 - Vendos objektiva në fillim të çdo semestri akademik dhe në fund vlerëson arritjen ose jo të tyre.

Neni 7

Fushat e studimit

QKSH ofron disa fusha studimi si më poshtë:

- Studimet mjedisore;
- Metodot fizike dhe instrumentale të analizës;
- Materiale dhe metodat inxhinerike, transporti dhe teknologjia detare;
- Zhvillim sistemesh në kohe reale, analizë statistikore të dhënash dhe modelim njohurish;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- Fusha të tjera që u interesojnë antarëve të FSHT;

Neni 8
Aktivitetet e QKSH-së

Në kuadër të veprimtarisë kërkimore-shkencore QKSH-ja kryhen këto veprimtari:

- Projekte kërkimi dhe vlerësimi në edukim
- Studime në fusha të ndryshme
- Trajnime /kualifikime
- Takime dhe workshope
- Shërbime për të tretët
- Pjesëmarrje në rrjete kombëtare e ndërkombëtare
- Asistencë teknike
- Prezantime
- Seminare
- Konferenca
- Sesione shkencore
- Tavolina të rrumbullakta.
- Përgatitje posterash, fletë palosjesh etj.

Neni 9
Kualifikimi i Stafit

Kualifikimi i stafit, sidomos kuadri i ri, është detyrë parësore dhe e vazhdueshme e QKSH-së, për të përballuar me cilësi programin për kërkim dhe zhvillim të qendrës.

Neni 10
Infrastruktura kërkimore-shkencore

Infrastruktura kërkimore-shkencore përfshin kryesisht: objektet, paisjet dhe shërbimet e nevojshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore, si laboratorët kërkimorë-shkencorë, bibliotekat shkencore, shërbimet informative shkencore, botimet shkencore dhe fushat e bashkëpunimit etj.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

KREU III
STRUKTURA ORGANIZATIVE E QKSH-FSHT

Neni 11
Përbërja dhe struktura e QKSH-FSHT

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.80/ 2015 të Arsimit të Lartë, bazuar në Vendimin Nr. 10, dt. 27.01.2017 të Senatit Akademik të Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë “Për miratimin e strukturës organizative dhe organigramës së Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë” në përbërje të Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike janë:

- Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore;
- Dy specialistë (staf akademik);
- Një personel ndihmës akademik me karakter administrativ në funksion të laborantit.



Neni 12
Funksionet e Stafit të QKSH

Funksionet kryesore të stafit të QKSH janë:

- Propozon pranë Dekanatit fondin vjetor të nevojshëm për punën kërkimore-shkencore dhe për funksionimin e QKSH dhe ndjek procedurat deri në miratimin përfundimtar të tyre;
- Menaxhon financimin e studimeve dhe të projekteve kërkimore shkencore, në përputhje me fondin e parashikuar në ligjin e buxhetit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- Përgatit raportin e veprimtarisë së QKSH, që i dërgohet Dekanit dhe Rektorit për miratim dhe më pas bëhet publike.

Neni 13

Mbledhjet e Stafit të QKSH

Stafi i QKSH-së mbledhet të paktën një herë në muaj dhe sa herë që e kërkon interesi i Qendrës. Mbledhja drejtohet nga Drejtuesi i Qendrës dhe në mungesë të tij nga njëri prej anëtarëve të stafit, i përcaktuar nga Drejtuesi. Nëse Drejtuesi nuk ka caktuar një anëtar, mbledhja drejtohet nga anëtari më i moshuar, që merr pjesë në mbledhje. Stafi funksionon sipas parimit të barazisë së anëtarëve.

KREU IV

DREJTIMI I QENDRËS KËRKIMORE-SHKENCORE

Neni 14

Drejtuesi i Qendrës

Drejtuesi i Qendrës është autoriteti drejtues i Qendrës Kërkimore Shkencore të FSHT. Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore duhet të jetë personel akademik i kategorisë të paktën Doktor i Shkencave.

Neni 15

Tagrat e përfaqësimit

Qendra Kërkimore-Shkencore në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga Drejtuesi i Qendrës dhe Dekani, në mungesë të tij, nga njëri prej dy përfaqësuesve, i cili autorizohet nga titullari.

Neni 16

Kompetencat

Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore ka këto kompetenca:

- Drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e QKSH-së;
- Është kryetar i grupit të punës për hartimin e Rregullores së brendshme të veprimtarisë së qendrës dhe ia paraqet për miratim Dekanit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Organizon analizën vjetore të punës, analiza periodike ose analiza të tjera për raste e aspekte të veçanta në qendër.
- Raporton, të paktën, dy herë në vit para Dekanatit për veprimtarinë e qendrës;
- Harton materialin mbi fondin vjetor të nevojshëm për punën kërkimore shkencore dhe për funksionimin e QKSH-së.
- Bashkërendon punën me stafin për zbatimin, me sukses të strategjisë së qeverisë për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin.
- Bashkëpunon me donatorë, vendas dhe të huaj, për sigurimin e fondeve të qendrës si dhe realizon menaxhimin e tyre;
- Krijon dhe zhvillon lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe institucioneve publike, me qëllim realizimin e detyrave dhe të objektivave të qendrës, si dhe të rritjes, gjithnjë e më tepër, të imazhit pozitiv të Universitetit të partnerët e huaj;
- Garanton cilësinë e materialeve informuese e promovuese, të kryera nga qendra, dhe shpërndarjen në kohë të tyre, institucioneve, publike dhe private, të interesuara;
- Përfaqëson komunitetin shkencor të Fakultetit të Shkencave Teknike në organizmat ndërkombëtarë të kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik.
- Përfaqëson Qendrën Kërkimore-Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike në të gjitha takimet me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, brenda ose jashtë vendit, dhe në mungesë të tij autorizon njërin prej dy përfaqësuesve të propozuar prej tij.

Neni 17

Rregullat e punësimit

Procedurat e emërimit të personelit dhe kriteret e marrjes në punë të personelit të Qendrës përcaktohen në bazë të statutit të Universitetit.

Neni 18

Etika në punë

Në kryerjen e funksioneve të tij, nëpunësi i qendrës duhet të respektojë rregullat e etikës në përputhje me Ligjin.Nr.9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU V
BURIMET E FINANCIMIT

Neni 19
Viti financiar

Viti financiar i qendrës fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomiko-financiar, i cili vlerësohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 20
Burimet bazë të financimit

Burim financimi i Qendrës Kërkimore-Shkencore si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Teknike është buxheti i shtetit.

Gjithashtu, qendra mund të sigurojë financime edhe nga granti i punës kërkimore-shkencore ku përfshihen fondet për kërkimin shkencor.

Qendra mund të sigurojë fonde shtesë edhe nga donatorë të ndryshëm, nga organizata ndërkombëtare për kërkimin shkencor, nga shërbimet që mund të ofrojë, nga sponsorizimet si dhe nga të ardhurat e veprimtarive të ndryshme, si aktivitete promocionale, simpoziume, konferenca dhe seminare.

KREU VI
ETIKA NË VERPIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE

Neni 21
Veprimtaria Kërkimore-Shkencore

Kërkimi shkencor efektiv synon të :

- Nxisë veprimtarinë kërkimore efektive
- Nxisë ndërgjegjësimin për të gjitha aktet ligjore e nënligjore të kërkimit shkencor;
- Hartojë dokumente, që përcaktojnë qartë politikat dhe procedurat e bazuara në këtë rregullore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- Nxisë vazhdimisht bashkëpunimin e ndërsjellë midis kërkuesve nëpërmjet shkëmbimit të hapur të ideve dhe respektimit të lirisë së shprehjes;
- Ruajë një klimë që nxit përgjegjshmëri dhe etikën në kërkim.
- Në ambjentet e qendrës mund të futen vetëm personat e autorizuar.

Neni 22

Monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë kërkimore

- QKSH-ja vlerëson veprimtarinë kërkimore të kryer nga kërkuesit shkencorë, jo vetëm për të vlerësuar përparimin e tyre në karrierën akademike, por edhe efikasitetin e fondeve të përdorura për kërkim në funksion të përmirësimit të politikave të kërkimit.
- QKSH-ja parashikon në politikat e tij ruajtjen e të dhënave dhe rezultateve të veprimtarisë kërkimore, si edhe të drejtën e konsultimit të tyre nga studiuesit e interesuar.
- QKSH-ja, harton një politikë për mbledhjen dhe ruajtjen e materialeve dhe të dhënave të kërkimit.
- Për projekte kërkimore afatshkurtra, që shërbejnë vetëm për qëllime vlerësimi, të tilla si projektet kërkimore të zhvilluara nga ana e studentëve, të dhënat kërkimore ruhen deri në 12 muaj pas përfundimit të projektit.
- QKZH-ja, krijon mjedise të sigurta për ruajtjen e të dhënave të veprimtarisë kërkimore.

Neni 23

Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore

- Veprimtaria kërkimore, ka për qëllim prodhimin dhe shtimin e njohurive kërkimore. Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore, bëhet në forma të ndryshme: revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, buletine me përmbledhje të referimeve, kumtesave të mbajtura në kuadër të një veprimtarie shkencore (simpozium, konferencë, kongres), monografi etj. Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore, është një hallkë mjaft e rëndësishme e procesit kërkimor, që e bën të njohur kërkuesin në gjirin e komunitetit akademiko-shkencor dhe i mundëson atij përmirësimin e kësaj veprimtarie duke e bërë atë të vlefshme për kërkuesit e tjerë dhe për mbarë komunitetin shkencor.
- Institucioni, publikon rezultatet e veprimtarisë kërkimore të zhvilluar në një mjedis, ku mbizotëron integriteti, besueshmëria dhe përgjegjësia.
- QKSH, publikon në faqen zyrtare të Universitetit në format të pamaniplueshëm përmbledhjet e referimeve shkencore të mbajtura në konferenca brenda dhe jashtë vendit, nga kërkuesit që ushtrojnë veprimtarinë kërkimore pranë tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 24

Autorësia

- Përhapja e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore, realizohet në mënyra të ndryshme, por format më të qëndrueshme, janë artikujt në revista shkencore, ku kërkuesi shkencor konsolidon emrin dhe pozitat e tij. Për t'u cilësuar si autor, kërkuesi jep një kontribut të rëndësishëm në kërkim dhe është i gatshëm të mbajë përgjegjësi për pjesën e punimeve në të cilat ka dhënë kontribut. Roli i tij është i pazëvendësueshëm dhe është një investim intelektual themelor, për hartimin e punimeve shkencore- zhvillimore.
- Hartimi i një artikulli shkencor, kërkon angazhimin serioz të autorit, jo vetëm në lidhje me shkrimin e rileximin e materialit, por mbi të gjitha punën kërkimore për mbledhjen e informacionit, verifikimin dhe citimin e burimeve të tij etj.
- Autorësia, në varësi të specifikës së disiplinës shkencore, bazohet në kontributet thelbësore që janë kombinimi i konceptimit, hartimit e zbatimit të një projekti dhe analizës së interpretimit të të dhënave e të rezultateve të veprimtarisë kërkimore, hartimit të pjesëve të rëndësishme të punës dhe rishikimit kritik të tyre, duke përfshirë interpretimin.
- Personat të cilët kanë kyer studimin e tyre dhe e kanë publikuar/referuar brenda ose jashtë vendit janë të detyruar të vendosin qendrën si affiliation.

Neni 25

Garantimi i etikës dhe konfidencialitetit

Te gjitha studimet dhe projektet kerkimore – shkencore të menaxhuara nga Qendra Kërkimore Shkencore do të sigurojnë konsideratat etike dhe bioetike që janë mënyra të cilat sigurojnë që të drejtat dhe mirëqënia e individëve apo komuniteteve që janë pjesëmarrës në studime shkencore nuk janë dhunuar.

Mbështetur në Deklaratën e Helsinkit studimet të cilat grumbullojnë informacion personal mbi subjektet, duhen dizenuar në një mënyrë etike që të mbrojnë individët pjesëmarrës në studim.

Konfidencialiteti, ruajtja e të dhënave personale të pjesëmarrësve në studime do ruhen në përputhje me Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU VII
DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 26
Vlerësimi i cilësisë

Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë kërkimore-shkencore të Qendrës Kërkimore-Shkencore do të kryhet nga Komisioni i Përhershëm në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, struktura dhe funksionimi i të cilave përcaktohen në statutin dhe rregulloren e Universitetit.

Neni 27
Analiza vjetore e veprimtarisë së QKSH

Në fillim të çdo viti akademik qendra vendos qëllimin dhe objektivat dhe në fund të çdo viti akademik përgatitet një raport vjetor mbi punën e kryer.

Neni 28
Vlefshmëria e rregullores

Kjo rregullore, pasi është diskutuar në mbledhjen e Komisionit të ngritur për hartimin e rregullores, firmoset nga Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore dhe i dërgohet Dekanit, i cili ja përcjell për miratim Senatit. Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit prej Senatit.